

2264 17.04.2014

Nr.Prot. ,datë / /2014



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

KRIJIMIN E BORDIT RINOR

Organizata jofitimprurëse, Intelektualet e rinj, Shprese te përfaqësuar nga sekretari I pergjithshem Z.Ergys Ivziku dhe Bashkia Shkoder përfaqësuar nga Z.Lorenc Luka-Kryetar I Bashkisë bien dakord për të bashkëpunuar si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi I Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit të organizatës Intelektualet e rinj ,Shprese dhe Bashkisë Shkoder për krijimin e bordit rinor ne Bashkinë Shkoder. Ky bord ka si synim mbledhjen së bashku te aktorëve rinor dhe institucioneve locale, për evidentimin e problematikave rinore ne qytetin e Shkodrës dhe paraqitjen e tyre para institucioneve vendimarrëse me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta. Realizimi I aksioneve të përbashkëta rinore ne sherbim të komunitetit.

Neni 2

Objekti

Krijimi I këtij Bordi Rinor synon ,të nxisë pjesmarrjen e te rinjeve në vendimarrjen locale.

Neni 3

Fusha e Zbatimit

Marrëveshja zbatohet midis strukturave të Shoqatës Intelektuale të rinj, Shprese dhe strukturave të Bashkisë Shkoder për të arritur qëllimin e përshkruar në nenin 1.

Neni 4

Bashkia Shkoder dhe strukturat vartëse të saj, marrin përsipër:

1. Ofrimin e ambjentit ku do realizohen mbledhjet e Bordit.
2. Përfaqsimin në bord me një përfaqësues zyrtar.
3. Mbështjen e iniciativave të vendimarrjes së bordit.
4. Ndërmjetimin në organet vendimarrëse për problematikat e evidentuara.

Neni 5

Shoqata Intelektuale të rinj, Shprese mere përsipër :

1. Kordinimin e të gjithë punës për ngritjen e Bordit Rinor:
 - a. Njoftimin e subjekteve pjesmarrëse të ciltët do jene: 1. Drejtoria Arsimore Rajonale Shkoder 2. Presidentat e senatit të shkollave të mesme: 28 Nëntori, Oso kuka, Shejnaze Juka, Jordan Misja 3. Këshilli I Qarkut Shkoder 4. Unioni Studentor 5. Shoqata Irsh 6. Shoqata Gruaja te Gruaja 7. Shoqata Qendra rinore Trokitja.
 - b. Drejtimin e Bordit deri në zgjedhjen e organeve drejtuese.
 - c. Asistenc teknike për realizimin e rregullores së brendshme të Bordit.
 - d. Firmosjen e Marrveshjes bashkupunitit mes subjekteve pjesmarrese.
 - dh. Sigurimin e materialeve të nevojshme për mbarvajtjen e Bordit.
2. Hartimi i rapoteve të rezultateve të mbledhjeve të Bordit.
3. Transparenca në vendimarrjen e bordit duke mundësuar mediatizimin e tyre.

